

Romeo GURAKUQI

RRUGA E MUNDIMSHME DREJT NJOHJES SË PAVARËSISË SË KOSOVËS*

Objekti i trajtesës është historia e trajtimit juridik të së drejtës shtetërore të Kosovës, parë në tri linja: atë të drejtës së brendshme kushtetuese, të drejtës ndërkombëtare, në pikëpamje të politikës europiano-perëndimore dhe SHBA-së. Teza që unë dua të shtroj në këtë konferencë mund të formulohet në këtë mënyrë: procesi juridik i shkëputjes së Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia ka ndjekur linjën normale kushtetuese, sikurse edhe për njësitë e tjera federative të Jugosllavisë. Edhe në pikëpamje të së drejtës ndërkombëtare, klasa politike kosovare ka ndjekur rrugën e njëllajtë shkëputësh, sikurse edhe të gjitha njësitë përbërëse të ish-Jugosllavisë së Dytë, të parashikuara nga kjo e drejtë.

Udhëheqësia rugoviane, me urtësinë e vet ka paraprirë politikat e vendeve perëndimore në procesin e njohjes së të drejtave, njerëzore, autonomiste, indipendentiste dhe shtetërore të Republikës së Kosovës, si shtet sovran. Përndryshe, suksesi i arritur, që në fakt ka përmbysur gjeopolitikën ballkanike dhe evropiane, është falë ndjekjes dhe mbështetjes së SHBA-së. Punimi është një ese historike e arsyetuar sot nga largësia kohore e gjykimit, por që mendoj se i shërben edhe momentit të ngërçit të sotëm të krijuar në përmbylljen e procesit të njohjes së plotë ndërkombëtare dhe njohjeve reciproke në mes Kosovës dhe Serbisë.

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor “Kosova 15 vjet pavarësi - sfidat dhe shtetformimi”, organizuar në Prishtinë, më 15 shkurt 2023.

Në pikëpamje juridike, të drejtën e Kosovës do të përpiqemi ta trajtojmë përmes shpjegimit të:

1. procesit konstitucional të shkëputjes së Kosovës nga Serbia;
2. të procesit të këputjes “konstitucionale” të autonomisë federative të Kosovës nga ana e Serbisë;
3. do të ballafaqojmë këto dy procese juridike të përkundërta, me tri parime themeltare të së drejtës ndërkombëtare, në njohjen e pavarësisë së një shteti: parimin e vetëvendosjes, mbrojtjen e një populli nga gjenocidi dhe doktrinën e *uti possidetis*;
4. do të argumentojmë, se statusi shtetëror i Kosovës, nuk mund të kishte fill të ndryshëm shqyrtimi nga diplomacia perëndimore nga startet e ndjekura edhe për njësitë e tjera federative të ish-RSFJ;
5. se kuadri legal i krijuar mbi Kosovën, në kornizën e së drejtës ndërkombëtare, nga Rezoluta 1244, ka qenë vetëm një situatë e përkohshme juridike dhe plotësisht paradoksale, nga pikëpamja teknike, e ndërtuar nga nevoja e kompromisit politik me Rusinë postdiktatoriale;
6. se paketa e presidentit Ahtisari është vetëm një rikthim logjik i të drejtës ndërkombëtare mbi Kosovën, afërsisht në të njëjtat linja, që kjo e drejtë është zbatuar, edhe për njësitë e tjera shtetformuese të ish-RSFJ;
7. politika amerikane mbi Kosovën pas 10 dhjetorit 2007 është prirë vendosmërisht për drejtimin e mirëfilltë të klasës politike të Kosovës për nga shpallja e pavarësisë së plotë dhe njohja ndërkombëtare;
8. pavarësimi, njohja ndërkombëtare, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe njohja e dyanshme me Serbinë, janë zhvillime të pashmangshme të fazës finale, e cila është në mbyllje e sipër, pavarësisht stanjacionit të përkohshëm, fazë që do të çojë në integrimin paralel të vendeve në BE dhe njohjen nga BE-ja edhe të Kosovës;

Në këtë ese do përpiqemi t’u japim përgjigje këtyre pyetjeve kërkimore:

- A ia doli Kosova, të barazojë, të rikompensojë në harkun kohor 1990-2008 statusin e dyfishtë dhe të pakuptimtë të imponuar nga rrethi politik udhëheqës jugosllavë me Kushtetutën e vitit 1974?
- A ishte ngritja e statusit të Kosovës në Republikë, një ngjitje legjitime e parashikuar Kushtetuta ngjashëm me secilën republikë ish-jugosllave në rrugën e shtetësisë dhe të sovranitetit të plotë apo një tejkalim i këtyre parashikimeve dhe rasteve anologe?

- A mund të realizohet një argumentim shkencor, historik dhe juridik i procesit të republikanizimit dhe pavarësimit të Kosovës?
- Pse politika perëndimore ka ndjekur nga pas përparimin e aspiratës kosovare për vetëvendosje, liri dhe shtetësi?

Linjat që ndjek analiza janë:

- procesi i heqjes së Autonomisë federative të Kosovës nga ana e Serbisë në vitet 1989-1991;
- rruga kushtetuese e shkëputjes së njësisë federative të Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia;
- pozicionet e KE/BE ndaj çështjes së njohjes së rrugës kushtetuese shkëputëse të Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia;
- plani i Ahtisarit, si bazë e ndërmjetme drejt njohjes së shtetësisë;
- situata kosovare 2000-2007;
- viti 2007- Kosova *de facto* shtet;
- Kosova pas 10 dhjetorit 2007, qëndrimi i USA, pavarësia dhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare mbi njohjen e pavarësisë.

T'i ndjekim me radhë secilën prej këtyre linjave në rendin kronologjik dhe t'i japim përgjigjet që mundemi.

Procesi i heqjes së Autonomisë Federative të Kosovës nga ana e Serbisë, 1989-1991

Dhunimi i pozitës juridike kushtetuese të Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974 të RFSJ-së, është kryer përmes një morie veprimesh dhe aktesh antikushtetuese prej udhëheqjes së Republikës së Serbisë duke filluar që nga viti 1981. Projekti i shkatërrimit të pozitës konstitucionale është mbështetur në të ashtuquajturin “Libri i Kaltër”, në të cilin, në kuadër të udhëheqësisë politike të Serbisë, përcaktohej strategjia e veprimit politik për ta ngushtuar dhe rrënuar mëvetësinë kushtetuese dhe politike të Kosovës. Sulmet ndaj pozitës kushtetuese të Kosovës u intensifikuan, pas Demonstratave të vitit 1981. Që nga viti 1981, e sidomos pas debateve kushtetuese të vitit 1988-1989, në opinionin serb dhe jugosllav u trajtua e ashtuquajtura “padrejtësi”, që i ishte bërë Serbisë në raport me njësitë e tjera

federale të Jugosllavisë dhe që kishin të bënë me statusin e dyfishtë të dy krahinave autonome, Kosovës dhe Vojvodinës. Aktet më të rëndësishme antikushtetuese të Serbisë, mbi bazën e të cilave, ajo e rrënoi ushtarakisht statusin kushtetues të Kosovës, kanë qenë si më poshtë vijon:

- amendamentet 4-49, të Kushtetutës së Serbisë, 28 mars 1989;
- ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethana të veçanta, të 26 qershorit 1990;
- Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 28 qershor 1990;
- Ligji mbi Ndalimin e Punës së Kuvendit të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, 5 korrik 1990;
- Ligji mbi Pezullimin e Punës së Kryesisë së KSA të Kosovës, 18 mars 1991;
- vendimi i Kuvendit të Serbisë për shkarkimin e përfaqësuesit të Kosovës në Kryesinë e RSFJ-së, 18 mars 1991;
- Kushtetuta e RFJ-së 27 prill 1991.

Sa më sipër ishte rruga që ndoqi Serbia për rikthimin, sipas saj, të sovranitetit republikan.

Procesi institucional i shkëputjes së Kosovës nga Serbia, 1990-1998

Ndërkohë, udhëheqja politike e shqiptarëve të Kosovës ndoqi rrugën legjitime brenda kornizës kushtetuese të Jugosllavisë. Si të gjitha njësitë e tjera përbërëse federative të ish-Jugosllavisë, Kosova, nën drejtimin e urtë të presidentit të saj Ibrahim Rugova, ndoqi deri më 1999, rrugët normale të vetëvendosjes, duke u udhëhequr nga parimi udhërrëfyes i së drejtës ndërkombëtare për krijimin e shtetit me sovranitet të plotë dhe përcaktimin e njohjen e kufijve të saj. Dua të kujtoj se fillimisht, delegatët e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, më 2 korrik të vitit 1990, miratuan shpalljen e “Deklaratës Kushtetuese për Kosovën”, si njësi e pavarur dhe e barabartë, në kuadër të Federatës Jugosllave. Materializimin kushtetues kjo deklaratë e mori, më 7 shtator 1990, në Kaçanik, kur Kuvendi i Kosovës (pas shpartallimit që i bëri Serbia ligjit kushtetues të saj), shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pas fillimit të proceseve dezintegruese të Jugosllavisë, për pesë ditë me radhë, më 26-30 shtator 1991, në Kosovë u mbajt një referendum mbarëpopullor, i cili njohu konstituimin e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Më 17 tetor 1991, u krijua Qeveria e Përkohshme e Kosovës në mërgim, e kryesuar nga dr. Bujar Bukoshi, dhe më 18 tetor 1991 Kuvendi i Kosovës miratoi më pas Rezolutën për Kosovën, si shtet sovran dhe i pavarur, amendamentet kushtetuese, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, (19 tetor 1991). Zgjedhjet e lira shumëpartiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës u mbajtën, më 24 maj 1991 (për të dytën herë, më 22 mars 1998). Më 24 maj 1992 edhe Ibrahim Rugova zgjidhet president, LDK-ja e tij fiton në Parlament 96 nga 144 deputetë, mirëpo sërish, siç pritej, zgjedhjet dhe deklaratimet u shpallën ilegale nga Beogradi.

Siç mund të vërehet nga paraqitja e fakteve të mësipërme, tërësia e rregullave ligjore të së drejtës së vetëvendosjes, ka pasur një impakt të thellë, në idenë dhe praktikën e shtetësisë së ndjekur nga udhëheqja politike kosovare e kohës. Ndaj, rruga e ndjekur nga liderët historikë të Republikës së Kosovës, fillimisht si njësi e barabartë e RSFJ-së e më pas si shtet i shkëputur nga Jugosllavia, mund të themi, ishte një rrugë e vlefshme nga pikëpamja juridike, por politikisht dhe ushtarakisht e pamundur nga pikëpamja praktike, për shkak të përmasës së turbulencës që shkaktoi në politikën globale, procesi tërësor dezintegrues i Jugosllavisë dhe vonesa që liderët botërorë krijuan, në dhënien e përgjigjeve të vlefshme këtij procesi mjaft të ndërlikuar, juridik, politik dhe mbi të gjitha ushtarak. Rruga e ndjekur nga udhëheqësit kosovarë u tentua të nulifikohej nga regjimi ushtarako-policor që Serbia vendosi në Kosovë, që imponoi *de facto* një periudhë të gjatë dypushtetesh: pushtetit të krijuar nga liderët e Republikës së Pavarur të Kosovës dhe atë të imponuar ushtarakisht nga regjimi i Millosheviqit, nëpërmjet një sërë aktesh me veshje kinse kushtetuese.

Rruga e mundimshme drejt njohjes nga ana e vendeve të KE/BE-së

Në fillimet e procesit të dezintegrimit të ish-Jugosllavisë, vendet e Komunitetit Evropian (më tej KE), qenë fillimisht pro ruajtjes së unitetit të Jugosllavisë dhe me lejen e autoriteteve federative, u përfshinë në proceset politike të trajtimit të situatës. Shtetet e KE-së synonin në këtë fazë fillestare,

një Jugosllavi të re, më pak të centralizuar nga pikëpamja konstitucionale. Për të mbështetur lëvizjet politike, shtetet e KE-së themeluan **Komisionin Badinter**, një njësi vlerësuese, që ndihmonte me këshilla përfaqësuesit e vendeve të KE-së, për Jugosllavinë.¹ Mirëpo, zhvillimet e vrullshme jugosllave e bënë gjithnjë e më evidente shpërbërjen e Federatës, e kjo ndikoi, që në vjeshtën e vitit 1991, vlerësimi i vendeve të KE-së të ndryshojë.

Këto vende u përpoqën të ushtrojnë një lloj ndikimi, mbi mënyrën se si do të duhej të menaxhohej procesi. Kjo mbasi ishte e qartë që për shtetet e reja që do të lindnin, do të duhej të krijoheshin disa linja bazore, mbi të cilat do të duhej të mbështetej identifikimi i shtetësisë. Për këtë, më 16 dhjetor 1991, ministrat e Jashtëm të vendeve të Komunitetit Evropian shpallën të ashtuquajturën *“Declaration on the Guidelines on Recognition of New States in Eastern Europe and the Soviet Union”*.² Në bazë të këtij dokumenti, vendet anëtare shprehën gatishmërinë për të njohur si subjekte shtetet e reja, bazuar në standardet normale të praktikës ndërkombëtare dhe realiteteve politike në secilin rast. Deklarata, asokohe, vendosi një numër kushtesh, për garantimin e minoriteteve, respektimin e kufijve, të cilët mund të ndryshoheshin vetëm me mjete paqësore, nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, pranimit të një marrëveshjeje për kontrollin e disa armëve dhe angazhimit për të zgjidhur nëpërmjet marrëveshjes të të gjitha çështjeve të trashëgimisë shtetërore të RSFJ-së. Në fund, deklarata përfundonte se shtetet e KE-së nuk do të njihnin entitetet, të cilat ishin krijuar si rezultat i agresioneve.

Është për të ardhur keq, që vendet e KE-së dështuan aso kohë në artikulin e frazës finale, që mund të kishte shmangur shumë orekset nacionaliste të Serbisë, jo vetëm mbi Kosovën: ata ndoshta do të duhej të deklaronin se nuk do të njihnin edhe sovranitetet e shteteve pasuese të Jugosllavisë, të shtrira mbi entitetet e veçanta federative të Jugosllavisë, nëpërmjet agresionit ushtarako-policor dhe jo nëpërmjet veprimit demokratik dhe konstitucional. Me kalimin e kohës, vendet e KE-së paraqitën një element tjetër të ri për sa i përket Jugosllavisë. Nëpërmjet “Declaration on Yugoslavia”, këto vende propozuan një procedurë për të përcaktuar kushtet

¹ Shih: Badinter Commission, Opinion, No.1-11, published in the years 1991-1992.

² <https://www.cambridge.org/core/books/abs/europe-and-the-recognition-of-new-states-in-yugoslavia/epc-declaration-on-the-recognition-of-new-states-in-eastern-europe-and-the-soviet-union-16-december-1991/C2E53D4E20CF1EE378A2BE03EDCE84DE>

që duhet të plotësoheshin për njohjen: së pari, duhej që vetë entitetet të dëshironin njohjen si shtete të pavarura; së dyti, këto entitete duhej të pranonin angazhimet e përcaktuara në “*Guidelines...*”; së treti, ata duhej të pranonin që mbrojtja e të drejtave njerëzore të minoriteteve, të merrej në shqyrtim prej Konferencës mbi Jugosllavinë; së katërti, që këto entitete të përshtatnin garanci kushtetuese dhe politike, se nuk paraqisnin pretendime territoriale përkundrejt ndonjë vendi të KE-së.³

Në këto rrethana, njëlloj sikurse Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Maqedonia, qeveria kosovare në mërgim e drejtuar nga dr. Bukoshi, pavarësisht se në kushtet e pushtimit ushtarak të ish-njësisë federative me emrin Kosovë, që në fillimet e veprimtarisë së vet, aplikoi më 23 dhjetor 1991, për njohje pranë shteteve të KE-së. Në përgatitjen e kërkesës punuan figura të shquara shkencëtarësh shqiptarë, mes të cilëve mund të përmend prof. Sami Repishtin. Kërkesa për njohje u shqyrtua nga Badinter Commission. Megjithëse, komisioni i lartpërmendur dha mendimin, se statusi si shtet ishte një çështje fakti dhe njohja një çështje deklarative dhe megjithëse komisioni shkoi përtej pozicioneve tradicionale duke vendosur theksin në të drejtën e popujve për vetëvendosje, mbi bazat e kufijve ekzistues territorialë, vendet e KE-së, nën presionin e vendeve mike të Serbisë, brenda kësaj bashkësie (Greqia dhe disa lobe drejtuese të politikës italiane, si dhe fatkeqësisht, ndërhyrja e drejtpërdrejtë e presidentit francez *François Mitterrand*), hodhën poshtë kërkesën e qeverisë kosovare.

Në këtë rast, jo e drejta ndërkombëtare, por arsyet e nevojave politike për kompromis brenda KE-së, ndërhynë në dhënien e një përgjigjeje, që duhej të ishte plotësisht juridike, në një kohë që, përgjegjësia politike duhej të ishte para së gjithash humanitare. Periudha nga viti 1992 deri në vitin 1998 është e mbushur me ngjarje që lidhen me luftën në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë, me shpalljen e Republikës së Tretë Federale Jugosllave më 27 prill 1992, Marrëveshjen e Daytonit (21 November 1995) që përfundoi luftën në B-H; njohjen e Jugosllavisë së Tretë nga Franca, më pas UK, Suedia, Danimarka, Holanda, Portugalia, Italia dhe Gjermania pas shkurtit 1996, çfarë do të thoshte edhe njohje e integritetit të Serbisë mbi Kosovën. Më 5 maj 1996,

³ <https://www.cambridge.org/core/journals/international-legal-materials/article/abs/european-community-declaration-on-yugoslavia-and-on-the-guidelines-on-the-recognition-of-new-states/9E18813E91A38E78863DF5807B4B4796>

Grupi i Kontaktit kërkoi autonomi të zgjeruar për Kosovën në kuadër të kufijve të RF të Jugosllavisë.

Kjo kërkesë u pasua më 20 janar 1997 nga Këshilli i Evropës. Më 25 shkurt 1998 Grupi i Kontaktit deklaroi se nuk mbështeste as pavarësinë e as ruajtjen e *status quo*-së aktuale në Kosovë. Ishte një shenjë e qartë se diçka po lëvizte në ndryshimin e qëndrimeve mbi Kosovë. Kështu, më, 6 mars 1998, Grupi i Kontaktit kërkoi tërheqjen brenda dy javëve të policisë speciale dhe në rast të kundërt mbi Serbinë do të vendoseshin sanksionet. Për të implementuar sa më sipër, më, 24 mars 1998, RF të Jugosllavisë iu kërkua fillimi i dialogut serioz dhe pa kushte me shqiptarët e Kosovës rreth statusit të ardhshëm të krahinës, mbasi statusi i imponuar ishte i papranueshëm. Serbia zyrtare filloi të ndjekë rrugën e zvarritjes së zgjidhjes me anë të mbajtjes së bisedimeve pa mbarim.

Më 15 maj 1998 me ndërmjetësimin e qeverisë së SHBA-së të përfaqësuar nga i dërguari i posaçëm Richard Holbrook, Millosheviqi dhe pala shqiptare e bisedimeve (e përfaqësuar nga Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Mahmut Bakalli, Veton Surroi) filluan negociatat pa parakushte në Beograd. Palët u shprehën për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Kosovë. Është koha kur në terren përplasjet vazhdonin dhe Serbia nuk po lehtësonte masat. Zgjatja e bisedimeve nuk mund të shkonte pambarimisht kur përplasjet vijonin dhe Serbia po kërkonte të mbante të pandryshuar situatën statutores. Ndërkombëtarët lëvizën dhe kaluan në një fazë të re angazhimi, që ngjan të ketë qenë një taktikë e zgjuar për të hequr çdo justifikim Serbisë dhe mbështetësve të saj ndërkombëtarë për të mos u ndëshkuar për krimet policore dhe çetnike që po kryheshin në Kosovë.

Më 6 shkurt 1999, nën Kryesinë e Presidencës së përbashkët të ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe (Cook) dhe atij të Francës (Védrin), fillojnë bisedimet e paqes për Kosovën në kështjellën e Rambujes në Paris, të cilat udhëhiqen nga ambasadorët Hill (SHBA), Petritsch (EU) dhe Majorski (Rusi). Marrëveshja e paqes e përgatitur me këtë rast do të duhej të garantonte autonomi për Kosovën dhe lidhje institucionale në RF Jugosllave. Është një modul tranzitiv taktik që perëndimorët siç duket përdorën për të ndarë “fajtorët” ballkanikë dhe për të hapur rrugën diplomatike drejt ndërhyrjes ushtarake në rast refuzimi. Mirëpo, më 23 shkurt 1999 bisedimet e para të Rambujes dështojnë dhe ndërpriten. Serbia nuk mund ta konceptonte këtë

pozicion të pastër autonomist para-indipendent të Kosovës. Duke ndjekur këshillat perëndimore shqiptarët e Kosovës, më 7 mars 1999, përmes Parlamentit të tyre Krahinor pranojnë Marrëveshjen e Rambujes. Pas këtij akti, më, 18 mars 1999 delegacioni shqiptar e nënshkruan Marrëveshjen (e përkohshme) të Rambujesë. Serbët refuzojnë nënshkrimin, me pretendimin se ata nuk pranonin stacionimin e një trupe ndërkombëtare të paqes në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Serbisë. Veprimi i radhës i tyre ishte kurthi ku ata vetë ranë: Ushtria jugosllave fillon një ofensivë të mirëfilltë në shkallë të gjerë në Kosovë. Për rrjedhojë, më 19 mars 1999, bisedimet për një marrëveshje të përkohshme mes Serbisë dhe Kosovës u pezulluan.

Rruga e ndërhyrjes ushtarake tanimë mbetet e vetmja alternativë. Shumica e shteteve perëndimore tërhoqëm ambasadat e veta nga kryeqyteti jugosllav, ndërsa më 24 mars 1999, NATO-ja fillon operacionin për çlirimin e Kosovës. Për më shumë se dy muaj Jugosllavia e zvogëluar u bombardua nga aeroplanët e Aleancës Atlantike. Çështja që duhej zgjidhur për të arritur në zgjidhjen finale pas ndërhyrjes ishte angazhimi i Rusisë. Më 2 qershor 1999 në Petersberg të Gjermanisë, shtetet e NATO-s dhe Rusia ranë në një mendje për një plan të paqes për Kosovën. Marti Ahtisari dhe Victor Chernomyrdin ia paraqiten planin presidentit Millosheviq në Beograd më 3 qershor 1999, i cili më pas urdhëroi aprovimin e tij në Parlamentin serb (136 vota pro kundrejt 74 kundër).

Më 9 qershor 1999 në Kumanovë (Maqedoni) pas pesë ditë bisedimesh, përfaqësuesit e NATO-s dhe ushtrisë jugosllave nënshkruan një marrëveshje ushtarako-teknike, e cila rregulloi modalitetet e largimit të ushtrisë jugosllave dhe policisë serbe nga Kosova. Ky ishte kapitullimi i Serbisë dhe akti i largimit të saj definitiv nga Kosova. Më 10 qershor 1999, NATO-ja i ndal përkohësisht sulmet e saj ajrore, pasi që vërtetohet tërheqja e trupave jugosllave.

Me abstenim të Kinës, Këshilli i Sigurimit të OKB-së miraton Rezolutën 1244 (1999): ai përmban mandatin për ngritjen e një prezence ndërkombëtare të sigurisë (KFOR), një administrim të përkohshëm civil (UNMIK) dhe çarmatosjen e UÇK-së.⁴ Në periudhën mes miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vitin

⁴ <https://unmik.unmissions.org/united-nations-resolution-1244>

1999 dhe Planit të Ahtisarit në vitin 2007, Kosova kaloi një periudhë të administrimit ndërkombëtar, të negociatave për shtetformimin dhe vetadministrimin. Rezoluta 1244 e vendosi Kosovën nën administrimin e përkohshëm të OKB-së dhe autorizimeve të NATO-s për t'i dhënë fund konfliktit në rajon. Gjatë kësaj kohe, Kosova në fakt qeverisej nga Misioni i Kombeve të Bashkimit në Kosovë (UNMIK).

Kjo periudhë kulmon me Planin e Ahtisarit, të nënshkruar nga i dërguari i posaçëm i OKB-së, Marti Ahtisari në vitin 2007, i cili përvijoi një plan për statusin e ardhshëm të Kosovës. Ai rekomandoi ndryshime të tjera për Kosovën, me një prani të fortë ndërkombëtare për sigurinë, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e tyre të pakicave. Plani u miratua nga disa vende, por u përball me kundërshtimin e disa shteteve tjera, duke çuar në një periudhë të re negociatash, që janë ende në zhvillim e sipër, që përbëjnë fazën e tetë, sipas përkufizimit të dhënë në krye të këtij punimi, të kësaj rruge të mundimshme drejt pavarësisë së njohur nga gjithë shtetet faktorë.

Çfarë ishte Plani i Ahtisari? Plani Ahtisari (që u bë i njohur në muajin shkurt të vitit 2007) ishte formalisht një propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, propozuar nga ish-presidenti i Finlandës Marti Ahtisari. Pikat e planit mbulonin një gamë të gjerë çështjes të lidhura me statusin e Kosovës. Disa prej këtyre përbërësve përfshinin ndërtimore të garancisë: Grupin Drejtues për Kosovën, Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar për Kosovën, Përfaqësuesin Special të BE-së për Kosovën të emëruar prej Këshillit të BE-së.⁵ Ndërkohë që Plani nuk përmendte fjalën pavarësi, ai përmbante në fakt një numër parashikimesh që gjerësisht interpretohen si pikat bazë të shtetësisë për Kosovën dhe këtu kemi parasysh të drejtën e Kosovës për të aplikuar në organizatat ndërkombëtare, të drejtën e krijimit të një force të sigurisë dhe të përshtatjes së simboleve kombëtare.

Propozimi përmbante një Kornizë Kushtetuese për Kosovën, garantimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, decentralizimin e qeverisjes lokale, një sistem të veçantë kosovar të drejtësisë, mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore, njohjen e borxhit ndërkombëtar që mbarte Kosova nga periudha jugosllave dhe serbe, njohje e pronave dhe

⁵ <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf>

arkivave, ndërtimin e një sistemi të sigurisë kombëtare, ngritjen e institucionit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar për Kosovën, ngritjen e një Mision Evropian të Sigurisë, Politikave të Mbrojtjes dhe Sundimit të Ligjit, prani ushtarake ndërkombëtare KFOR-it dhe e drejta e nxjerrjes së ligjeve.

Disa konsiderata politike për situatën e vitit 2007

Pas paraqitjes në shkurt 2007 të Planit të Ahtisarit, në verën e vitit 2007 u zhvilluan bisedime 120-ditore, të cilat u dhanë mundësinë ekipit negociator shqiptar të asaj kohë, të argumentojnë jo vetëm se plani i president Marti Ahtisari është rruga e kompromisit të mundshëm, por njëkohësisht, kjo kohë shërbeu si një periudhë e artë, për stabilizimin shtetëror, për të filluar procesin përgatitor të njohjes ndërkombëtare të Kosovës, si shtet i pavarur, bazuar në pretendimin dhe faktin e të sjellit si shtet. Nga ky moment filloi një argumentim, i bazuar në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe në logjikën e ndjekur nga komuniteti ndërkombëtar, edhe për rastet e shteteve të tjera të ish-Jugosllavisë, se Kosova, asokohe *de jure* protektorat i OKB-së, zotëronte *de facto*, të gjitha elementet e shtetësisë. Këta elementë, që në planin e brendshëm kosovar, kanë filluar të krijohen nga momenti i shpalljes së Republikës së Kosovës, në planin e jashtëm ndërkombëtar janë njohur deri në nivelin e kushteve të veçanta, të krijuara nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB dhe me vështirësi, po zgjateshin drejt projektit Ahtisari.

Mirëpo, të kundërtën, asokohe po bënte Serbia dhe institucionet e saj: ajo, jo vetëm mbeti në mënyrë të kamufluar në veri të Kosovës (4 komunat veriore: *Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok*), por në planin ndërkombëtar filloi përpjekjet të argumentojë, se Kosova, në bazë të së drejtës ndërkombëtare, ishte pjesë integrale e Serbisë. Serbia, e ndodhur në pozicionin e vështirë të humbjes *de facto*, të territorit të fituar si plaçkë lufte, nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913 (Rezoluta 1244 e KS të OKB-së përjashtoi autoritetin e Serbisë mbi Kosovën, por pranoi tërësinë territoriale të RFJ-së, një prej nonsenseve të arritura për të mbajtur nën kontroll kundërshtitë mes fuqive), po përpiqej të shpërbënte përgjegjësinë shtetërore të Serbisë së vitit 2007 nga ajo e Serbisë së drejtuar nga Slllobodan Millosheviqi. Mirëpo kjo shpërbërje mund të ndodhte vetëm në rast “harrese” të etnocidit shtetëror të Serbisë, 1998-1999, dhe të historisë

politiko-juridike të shkëputjes së Republikës së Kosovës nga RSFJ-ja. Vetëm kjo “harresë” mund ta shpëtonte, mund ta nulifikonte të drejtën e një populli për shkëputje. Ishte një objektiv mjaft i vështirë për Serbinë, por jo i pamundur, kur mendojmë se Serbia e asaj kohe dhe në njëfarë mënyre edhe kjo e sotmja, kishte dhe ka në krah një aleat aq të rëndësishëm dhe aq të fuqishëm si Rusia, trashëgimtare e denjë e Perandorisë Cariste. (Kujtoj se një objektiv të ngjashëm me atë, që në agjendën e tij kishte në këtë periudhë të marrë në shqyrtim ministri i Jashtëm, Vuk Jeremiq, kishte pasur gati dy shekuj më parë ministri i Jashtëm i Francës së Luigjit XVIII, në Kongresin e Vjenës, 1814-1815 Talleyrand: shpërbërja e përgjegjësisë së Francës së epokës së Restaurimit nga përgjegjësia e Francës së periudhës napoleoniane, i cili edhe ia pat arritur, por kuptohet, në kushtet e reaksionit restaurues post-napoleonian). Pyetja është: A mund të shpërbëhet përgjegjësia shtetërore në një kohë aq të afërt, kur mbi barrën e institucioneve të atij shteti qëndrojnë vendimmarrje për ushtrim të targetuar të dhunës dhe të shkeljes flagrante të lirive?

Në vitin 2007 ishim në kushte historike krejtësisht të ndryshme dhe në të drejtën ndërkombëtare, shkëputja dhe formimi i një shteti të ri mund të pranohej kur, së paku, konstatohet gjenocidi, shpërngulja e dhunshme dhe shfarosja pa lënë gjurmë në popullsinë civile, kur qeveria qendrore nuk përfaqëson më, prej dekadash, popullin e një entiteti shtetformues. Serbia mund ta realizonte objektivin e saj të padrejtë, vetëm nëse SHBA-ja dhe BE-ja do të detyroheshin të lëshonin terren, në mbrojtjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtare të pranura botërisht, për njohjen e shteteve të reja të çliruara nga zgjedhat kolonialiste, të shpëtuara nga gjenocidi dhe shteteve të tjera të lindura nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, para presioneve anakronike të Rusisë. Dhe kjo nuk kishte asnjë mundësi të ndodhte.

Kosova *de facto* shtet, argumentimi

Megjithëse, Kosova e vitit 2007, në aspektin ndërkombëtar nuk njihej ende si shtet, ajo zotëronte karakteristikat materiale dhe ato të brendshme juridike të shtetësisë. Shtetësia, vërtet është një koncept i rregulluar prej së drejtës ndërkombëtare dhe jo një çështjeje materialisht faktike, por të qenit materialisht dhe faktikisht shtet, është thelbësisht një cilësi ligjore, e cila e

bën një entitet parimisht shtet. Shteti, si një subjekt i së drejtës ndërkombëtare, duhet të zotërojë cilësimet e mëposhtme: 1. të ketë një popullsi të përherëshme; 2. një territor të përcaktuar qartë; 3. një qeveri sovrane; 4. kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.⁶ Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, pas etnocidit të viteve 1998 dhe 1999 dhe ndërhyrjes së NATO-s për shpëtimin e popullit shqiptar nga spastrimi etnik, krijoi mbi Kosovën, si njësi e veçantë federative e ish-RSFJ-së, kushtet për zhvillimin e një qeverisjeje të strukturuar sovrane. Kosova, nga 15 maji 2001, krijoi një “*Constitutional Framework for Provisional Self-Government*”⁷

Kjo “kornizë kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme” e përcaktoi Kosovën një entitet të veçantë, një protektorat nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar dhe një territor të pandashëm. Kosova kishte dhe përmirësoi gjatë kësaj kohe, një sistem ligjor të veçantë, një sistem qeverisjeje qendrore dhe lokale të zgjedhur në mënyrë demokratike, një sistem të drejtësisë të veçantë dhe kapacitetin *de facto* për të pritur misionet diplomatike të shteteve të tjera. Sovraniteti i këtyre institucioneve ishte i kufizuar vetëm nga pozicioni i kreut të Misionit të UNMIK dhe funksioni mbrojtës i KFOR-it.

Është e vërtetë, që Rezoluta 1244 respektonte sovranitetin dhe integritetin territorial të RFJ-së, përfshirë Kosovën, por natyra e këtij sovraniteti ka qenë pastërtisht nominale, përderisa kjo rezolutë, nëpërmjet konsiderimit “popull” të banorëve të kësaj krahine, njohu në fakt edhe të drejtën për vetëvendosje të këtij entiteti. Kosova ishte *de facto* protektorat i OKB-së dhe protektoratet e deritanishme të OKB-së, kanë përfunduar përherë në pavarësi.⁸ Territori mbi të cilin ushtron aktivitetin qeveria e zgjedhur e Kosovës është gjegjësisht, territori i njëres prej 8 njësive të barabarta federative, të ish-RSFJ-së, Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, bazuar në Kushtetutën e vitit 1974, që përkon me territorin që Serbia pushtoi nga

⁶ Colin Warbrick, *State and Recognition in International Law*, at International Law, Second Edition, Edited by Malcolm D. Evans, Oxford University Press, 2006, faqe 231

⁷ https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2001regs/RE2001_09.pdf

⁸ Colin Warbrick, *State and Recognition in International Law*, at International Law, Second Edition, Edited by Malcolm D. Evans, Oxford University Press, 2006, Status and rights- 242-243, The ‘Juridical’ state -243-247.

tokat e konsideruara shqiptare, të Perandorisë Osmane, më 1913.

Me Rezolutën 1244, u ndërmor vetëm hapi i parë për shkëputjen e njësisë federative të radhës së ish-Jugosllavisë nga Serbia. Kjo, sepse ndarja konsensuale e kërkuar nga shqiptarët, si një opsion i pranuar nga e drejta ndërkombëtare, u kapërcye nga terrori i viteve 1998-1999. Duke njohur realitetet konstitucionale të ish-RSFJ-së, Rezoluta 1244 u përpoq ta trajtonte Kosovën si një prej shkëputjeve të radhës, së njësive përbërëse të Federatës Jugosllave, por u detyrua të ndiqte një rrugë të ndërmjetme, nga nevoja për të bërë llogari, me kundërshtimin sistematik të Ruisë dhe abstenimin e Kinës. Rezoluta 1244 vërtet pranoi tërësinë territoriale të Serbisë, por këtë e bëri si koncesion për pjesëmarrjen ruse (këtë e ka pranuar më shumë se një herë ish-Sekretarja amerikane e Shtetit e asokohe, Allbright). D.m.th. nevoja e një kompromisi politik me Rusinë, krijoi një realitet të pangjashëm juridik në marrëdhëniet ndërkombëtare për Kosovën, me të cilin në prag të shpalljes së Pavarësisë më 2008, politikanëve të Kosovës iu desh të bëjnë llogari, por edhe fuqitë perëndimore në këtë moment final vendimmarrjeje. Në fakt edhe 5 shtete të BE-së nuk do ta njohin Kosovën duke penguar deri më tani njohjen zyrtare të BE-së në tërësi.

Rruga e mundimshme drejt njohjes, pas vitit 2007

Dy janë çështjet me të cilat u mor intensivisht diplomacia lëvizëse dhe jolëvizëse e aktorëve kryesorë të politikës globale, pas shpalljes së Planit të Ahtisari: 1. njohja ose jo e pavarësisë së mbikëqyrur; 2. territori mbi të cilin do të duhet të njihet ky lloj pavarësie. Para së gjithash, duhet të nënvizojmë se për arsye historike, juridike dhe politike, të dyja çështjet janë të lidhura dhe të ndërvarura. Ato janë pjesë e aktit të fundit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, krijesës që Franca realizoi në përfundim të Luftës së Parë Botërore, (të rikonfirmuar edhe pas LDB-së në agimin e ndarjes së botës në prag të Luftës së Ftohtë), dhe mund të them pa ndrojtje, lindjes së vështirë të shtetit të fundit nga ish-RSFJ-ja.

Si pasojë e kësaj lindjeje të mundimshme, Serbia do të mund të zmbrapset në kufijtë e saj natyrorë, duke pritur procesin integruar në BE, ndërsa Kosova, e banuar historikisht përhershmërisht nga shqiptarë, serbë dhe të tjerë, do të mund të konstituohet si shtet evropian, që respekton

njëmendësisht standardet europiane e të drejtat politike dhe kulturore të barabarta të të gjithë popujve dhe pakicave, duke pasur parasysh këtu edhe të drejtat e shqiptarëve të të dy religjioneve pa i konfunduar ata nën një kupolë (gjë që në fakt nuk ndodh. Plani Ahtisari dhe më pas Kushtetuta nuk e ka parashikuar një paragraf të tillë, që ka dalë sot kaq i domosdoshëm të amendohet në Kushtetutë). Kostituimi i këtij shteti nuk mund të ndodhte ndryshe veçse brenda territorit të ish-KSA-së së Kosovës. Kjo sepse në të gjithë historinë 17-18-vjeçare të dezintegrimit të Jugosllavisë deri atëherë (2007-2008), linjat territoriale dezintegruese dhe shtetformuese qenë të bazuara tërësisht dhe pa asnjë përjashtim, në parimin e së drejtës ndërkombëtare të *uti possidetis*. *Uti possidetis* është një parim i përgjithshëm, i cili është logjikisht i lidhur me fenomenin e fitores së pavarësisë, kudo ku ky fenomen shfaqet. Qëllimi i tij i vetëm është që të parandalojë, që pavarësia dhe qëndrueshmëria e shteteve të reja të dëmtohet prej luftërave vëllavrasëse, të shkaktuara prej ndryshimit të kufijve që pason tërheqjen e ish-administruesve të dikurshëm. Ky parim, i formuluar kështu, nuk është vetëm një parim teorik i shkencëtarëve të së drejtës ndërkombëtare, por ka gjetur zbatim edhe në një interpretim të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i mirënjohur nga të gjithë, realizuar më 1986, në kohën e shqyrtimit të çështjes Burkina Faso-Mali.⁹

Për të qenë më të qartë, le të ndjekim pak historinë: pas Luftës së Dytë Botërore, në përgjithësi, shtetësia u njoh ose u vendos brenda territoreve të secilës njësi administrative koloniale, kufijtë e të cilave ishin nganjëherë kufijtë ndërkombëtarë në mes kolonive të shteteve të ndryshme, ose ishin kufijtë e brendshëm administrativë të një fuqie të vetme koloniale. Kjo praktikë e ndjekur për njohjen e shtetësisë dhe kufijve ishte një adoptim i parimit të së drejtës romake të *uti possidetis*, që kishte filluar të zbatohet me krijimin e shteteve në kolonitë spanjolle të Amerikës Latine. Duke përdorur kufijtë tashmë të vendosur, krijohej thelbësisht mundësia për të identifikuar si territorin në të cilin opsioni i shtetësisë do të ushtrohej, ashtu edhe popullsinë e këtij territori, e cila është e titulluar për ta bërë këtë zgjedhje pavarësimi. Parimi i *uti possidetis* është tashmë një parim që zbatohet në

⁹ Colin Warbrick, *State and Recognition in International Law*, at International Law, Second Edition, Edited by Malcolm D. Evans, Oxford University Press, 2006, faqe 225-228.

formë të përgjithshme dhe të padiskutueshme.

Gjithashtu është e nevojshme të cilësojmë, se në mes parimit të *uti possidetis* dhe parimit të vetëvendosjes, ekziston një marrëdhënie e ngushtë. Në kuptimin normativ, më së pari duhet të bazohemi në dy konventat e Kombeve të Bashkuara, mbi të drejtat e njeriut, të cilat flasin për të drejtën e vetëvendosjes për të gjithë popujt. Zhvillimi i së drejtës së vetëvendosjes ka pasur një impakt thelbësor mbi përmbajtjen e kriterëve të shtetësisë. Parimi i vetëvendosjes ka qenë operativ jo vetëm në procesin e dekolonializmit, por u bë veprues edhe përtej kontekstit kolonial, duke u shtrirë edhe në rastin e dezintegritit të ish-Jugosllavisë, proces nga i cili, Kosova s’kishte pse të bëjë përjashtim dhe kjo më pas u konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare.

Gjithsesi, këto parashikime nuk i japin të drejtën çdo grupi të vetëshpallur popull, të formojnë një shtet. Si mund të interpretohet sa më sipër për rastin tonë? Kosova nuk përbëhej nga një grup minoritar brenda një shteti, që kërkonte të vetëngrihej në statusin e një populli. Kosova banohet nga më shumë se 2 milionë shqiptarë të të dy besimeve fetare dhe popuj të tjerë, është ish-pjesë shtetformuese e Jugosllavisë, njëlloj si Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, territori i cili, nga viti 1981 deri më 1999, iu nënshtrua një terrori diktatorial policor të mirënjohur, ndërsa më 1999 popullsia e këtij territori iu nënshtrua, as më pak dhe as më shumë, por një etnocidi të paparë, ndjekur *live* nga e gjithë bota. Vetë Rezoluta 1244 i cilësonte banorët e këtij entiteti “popull”.

Rasti i Kosovës nuk është rasti i një grupi popullsie të një territori të një shteti, le të themi si rasti i Quebec në Kanada, ku qeveria qendrore e përfaqësonte popullin në tërësi mbi bazën e barazisë dhe pa diskriminim, por rasti i një populli të barabartë shtetformues të ish-Jugosllavisë, që në momentin e trazirës jugosllave iu nënshtrua etnocidit më të pashembullt, të fundshekullit XX, ku nga viti 1991 e deri më 2008 kur u shpall pavarësia dhe u krye njohja nga shtetet kryesore të botës, ka qenë e papërfaqësuar në qeverisjen qendrore në Beograd, qoftë në planin republikan, qoftë në planin federativ dhe konfederativ. Që nga qershori 1991, qeveria serbe nuk ushtronte autoritet mbi Kosovën. Për më tepër, me Marrëveshjen e Kumanovës, qershor 1999, ajo qeveri pranoi që Kosova të mbetej nën kujdesin e OKB-së deri sa të gjendet një zgjidhje nga OKB-ja. Kësisoj, Serbia dje (2008) dhe Serbia aktuale e sotme (2023), nuk mund të fshijë këtë boshllëk 33-vjeçar

mospërfaqësimi institucional dhe politik dhe nuk mund ta shpërbëjë vetveten, nga përgjegjësia shtetërore e Serbisë së drejtuar nga Millosheviqi për gjenocidin e ushtruar.

Kosova është një prej njësive shtetformuese trashëgimtare e ish-Jugosllavisë bazuar në Kushtetutën e vitit 1974. Ndokush mund të pretendojë se ky status shtetformues i është hequr Kosovës, mbi bazën e atyre akteve “kushtetuese” që i dhamë më lart, por kushdo që ka ndjekur me vëmendje ngjarjet e ish-Jugosllavisë dhe ka parë tanket e Millosheviqit mbi Slloveninë, Kroacinë dhe mbi fëmijët e Bosnjës e Kosovës, mund ta kuptojë mjaft mirë, se nuk kemi të bëjmë me një akt të vlefshëm, për t’u marrë në konsideratë nga pikëpamja juridike, përderisa një gjë e tillë nuk është kryer në kushtet normale, të funksionimit të mekanizmave demokratikë ligjore dhe referendarë. Ka qenë kjo arsyeja që vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare është bazuar në konceptet ligjore të shtetësisë dhe të vetëvendosjes, njëlloj sikurse për të gjitha njësitë e tjera përbërëse të ish-Jugosllavisë, është zbatuar më pas edhe në rastin e njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës nga më shumë se 100 shtete sovraane.

Sipas së drejtës ndërkombëtare, një popull ka të drejtën e shkëputjes, në qoftë se shteti federativ është në proces shpërbërje, siç ishte Jugosllavia në vitet 1991-1995. Shqiptarët e Kosovës kanë ndjekur vetë të njëjtat rrugë, sikurse, edhe njësitë e tjera shtetformuese të-ish Jugosllavisë, pavarësisht se tanket e ushtrisë serbe e bënë praktikisht të pamundshme, ushtrimin e plotë të pavarësisë. Pamundësimi me mjete ushtarake nuk legjitimon mosekzistencën materiale të qenies shtetërore dhe qeverisëse. Rasti i Kosovës nuk kishte asgjë të përbashkët me rastin e rajonit të Krajinės në Kroaci, ku kemi të bëjmë me një grup etnik territorial, që asnjëherë nuk i ka pasur të drejta shtetformuese të njohura konstitucionalisht. Pranimi i paketës së propozuar nga Ahtisaari përfaqësoi kthimin më të përafërt në legjitimitetin e të drejtës ndërkombëtare, njohjen e një realiteti juridiko-politik, të ndërtuar tashmë, nga populli kosovar, ngjashmërisht me popujt e tjerë shtetformues, të ish-RSFJ-së, nga viti 1991, është njohja *de jure* e të drejtës së një *populli* për vetëvendosje deri në shkëputje, në rrethanat e pas një shtypjeje gjenocidale dhe në kushtet e mospërfaqësimit institucional e demokratik nga Serbia, nga vitit 1991 deri më sot.

Në fund të fundit, e drejta ndërkombëtare shkruhet *post-factum*. Fillimisht, ndodhin ngjarjet, ndërsa më vonë bashkësia ndërkombëtare mbledhet dhe formulon justifikimin, i cili bëhet ligj për rastet e mëvonshme. Pranimi i Planit të Ahtisarit, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare përmbylli paqësisht, fazën e fundit të dezintegrimit të Jugosllavisë së dytë dhe hapi rrugën për integrimin evropian të Serbisë dhe europianizimin politik e institucional të Kosovës. Moszbatimi i tij do të shkaktojë një shpëputje të njëanshme të Kosovës dhe një situatë të paqartë në Evropën Juglindore.¹⁰

Kosova pas 10 dhjetorit 2007, qëndrimi amerikan drejt njohjes se pavarësisë se plotë

Më 1 nëntor 2007, Nënsekretari amerikan i Shtetit, asokohe i treti në rangun e këtij institucioni, Nicholas Burns, zhvilloi një leksion të hapur publik në një nga auditorët e *London School of Economics and Political Sciences*, një ndër shkollat pararojë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Perëndim në fushat e studimeve evropiane, në të cilin, ai foli për prioritetet e politikës së jashtme amerikane.

Duke qenë se kam qenë pjesë e atij institucioni si Research Fellow, e kam ndjekur asokohe më vëmendje personalisht këtë leksion. Një vend të veçantë në tërësinë e çështjeve të trajtuara zuri çështja e Kosovës. Në gjykimin tim, ato çfarë ambasadori Burns tha aso kohë, për çështjen më të nxehtë të Evropës së vitit 2007, përbënin një zhvillim të ri të avancuar në linjën e Planit të Ahtisarit, që hapte para politikës evropiane një sprovë të re, të cilës ky bashkim do të duhej t'i bashkëngjitet. Nga ana tjetër, konteksti i prezantimit të ambasadorit Burns për aktorët e politikës kosovare dhe shqiptare, krijonte “detyra të ngutshme” për lexim të kujdesshëm dhe për trajtim po aq të matur, të periudhës pas datës 10 dhjetor 2007.¹¹

Më konkretisht, ambasadori Burns fillimisht deklaroi, se “*në qoftë se bisedimet e parashikuara për të përfunduar më 10 dhjetor nuk arrijnë në një marrëveshje, atëherë ne duhet të përgatitemi për lëvizjen e radhës. Por*

¹⁰ Colin Warbrick, *State and Recognition in International Law*, at International Law, Second Edition, Edited by Malcolm D. Evans, Oxford University Press, 2006, Practice- The Soviet Union and Yugoslavia after 1989, Faqe 263-268.

¹¹ http://london.usembassy.gov/ukpa_press64.html.

SHBA-ja natyrisht, do të mbështet planin e propozuar nga Mr. Ahtisaari, ish-president i Finlandës, plan që përfaqëson një këndvështrim shumë definitiv për të ardhmen". Më pas, duke folur për politikën konstante amerikane të aleancës dhe përkrahjes së lirisë dhe paqes në Europë, ai u shpreh se, *"interesat tona më të thella, në kuadrin e interesave globale amerikane, janë këtu në Evropë: dërgimi i 50 000 trupave amerikane dhe evropiane nga presidenti Clinton, në qershorin e vitit 1999, për të shpëtuar një milion kosovarë shqiptarë nga pastrimi etnik, është një tregues për këtë Ndërhyrja në Bosnjë dhe Kosovë është një gur themeltar i aleancës mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës dhe aleancës sonë trans-Atlantike".*¹² Burns shtoi më pas, se: *"Evropa është kontinenti i parë në botë që po gëzon paqen dhe frytet e saj... Një prej mrekullive të epokës sonë është krijimi i Bashkimit Evropian dhe zhvillimet që ka bërë ky bashkim, në 25-30 vjetët e fundit. Ne besojmë... se jo çfarë ne do të duhet të bëjmë së bashku me ju, është të mbështesim këtë progres në Evropë dhe të sigurohemi dhe kujdesemi për të përfunduar këtë biznes të papërfunduar në Ballkan, në mënyrë që e gjithë Evropa të jetë e lirë dhe në paqe: pjesa perëndimore, pjesa qendrore tani të përfshijë edhe Ballkanin, dhe në dhjetëvjeçarin e ardhshëm, ose kështu pak a shumë, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova, si anëtarë të ardhshëm të BE-së dhe anëtarë të ardhshëm të NATO-s. Ajo çfarë po ndodh është ajo që Ronald Reagan, Margaret Thatcher, François Mitterrand dhe Helmut Kohl, me vizionin e tyre, kishin projektuar në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990: një Europë e tërë e lirë dhe në paqe është duke u krijuar tani".*¹³

Sfidës së një pyetjeje të bërë nga të pranishmit mbi mundësinë e një çarjeje të aleancës mes BE-së dhe SHBA-së, për shkak të presionit rus në sfidat e politikës globale, posaçërisht për rastin kosovar, Burns iu përgjigj: *"SHBA-ja nuk do të bëjë asnjë hap përpara në çështjen e Kosovës, pa bashkëpunimin me aleatët evropianë të NATO-s dhe në këtë drejtim nuk ka asnjë ballafaqim. Në rastin e Kosovës, aktorët drejtues të forcave në fushën kosovare të veprimit janë: Britania e Madhe, Gjermania, Franca, SHBA-ja, Italia, ata që kanë forcat e tyre dhe kanë financuar zhvillimin dhe paqen e*

¹² Po aty.

¹³ Po aty

Kosovës për 8 vjet e gjysmë. Rusia e lëshoi Kosovën tetë vjet më parë. Shtetet kryesore të NATO-s janë ato që i drejtojnë bisedimet. Në qoftë se, bisedimet mes palëve deri më 10 dhjetor nuk arrijnë në një përfundim, atëherë zgjidhja e problemit është më së shumti një çështje, një projekt amerikan dhe europiano-perëndimor”¹⁴.

Sa më sipër, përbëjnë pak a shumë linjat e përgjithshme mbi të cilat drejtohej Uashingtoni, në çështjen kosovare, pas vitit 2007. Më duhet të nënvizoj, se vizioni amerikan për Kosovën dhe Ballkanin, pas 10 dhjetorit 2007, ishte vizioni i një Kosove të lirë dhe i një Ballkani në paqe. Rindërtimi institucional i Kosovës do të ishte i kornizuar sipas projekt-planit të propozuar prej presidentit Ahtisari. Në hapjen e këtij procesi njohjeje ndërkombëtare dhe rindërtimi të orientuar proevropian, rolin kryesor do ta luajnë SHBA-ja dhe BE-ja. E ardhmja e këtij entiteti dhe perspektiva e këtij vendi do të orientohej mbi të njëjtën rrugë, me të gjitha shtetet ballkanike (pra edhe e njëllotë me ato nga pikëpamja statutores), që ecin në linjën integruese në BE, përfshirë edhe Serbinë (politikat integruese të Ballkanit Perëndimor në BE). SHBA-ja do të ndiqte edhe më tutje rrugët e tjera ligjore të parashikuara nga e drejta ndërkombëtare në njohjen e shtetësisë së Kosovës. Por, bazuar në kriteret ligjore të së drejtës ndërkombëtare, kush do ta bëjë njohjen e shtetësisë së Kosovës?

Fillimisht, pretendimin e parë për ekzistencën e shtetit *de facto* të Kosovës do të duhet ta bënte vetë Kosova, nëpërmjet organeve të saj të ligjshme, të zgjedhura demokratikisht në zgjedhjet e lira, organe të cilat do të duhej të shpallnin, se Kosova është *de facto* shtet dhe dëshiron të konsiderohet i tillë edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Organet përfaqësuese të Kosovës, me kohë e kishin bërë një gjë të tillë dhe e kishin vullnetin për ta përsëritur sërish, por qenë përmbajtur në këtë drejtim nën ndikimin e faktorit ndërkombëtar. Ky faktor, nën frikën e precipitimit të situatës ballkanike, vazhdonte ta mbante ende të frenuar rishpalljen dhe kërkesën, në pritje të ezaurimit të mundësive për marrëveshje dhe për të kontrolluar situatën nëpërmjet hapave të kujdesshëm. Domethënë, pozicioni ligjor për sa i përket çështjes së njohjes, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, nuk ndryshonte nga çështje të tjera ligjore: d.m.th., vendimi fillestar duhej të bëhej nga secili shtet

¹⁴ Po aty.

individualisht në mirëbesim, në një kohë që njohja kolektive nëpërmjet OKB-së, mbahej në mënyrë të pajustificuar, e bllokuar nga Rusia.

Kështu, në rastin e Kosovës ndodhte/ndodh ende, që një shtet, Serbia, ka një qëndrim të kundërt me entitetin pretendues mbi ekzistencën e shtetësisë. Në bazë të së drejtës ndërkombëtare hapi i parë për ta zgjidhur këtë ndryshim qëndrimesh, është rruga e paqtë e bisedimeve. Bisedimet për këtë çështje mbylleshin asokohe, më 10 dhjetor 2007 dhe sipas të gjitha gjasave, qëndrimet e ndryshme nuk kishin shanse të përafrohen. Pas datës 10 dhjetor, afatit i fundit i lënë nga bashkësia ndërkombëtare, hapej mundësia ligjore që Kosova ta shpallte vetë pavarësinë dhe shteteve perëndimore për ta njohur Kosovën individualisht, ose nëpërmjet një deklarate të njëkohshme SHBA, BE, të cilës, sipas të gjitha gjasave mund t'i bashkëngjiteshin shumë shtete të tjera, përfshirë Republikën e Shqipërisë. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia.

Kjo shpallje e pavarësisë ishte një ngjarje e rëndësishme në rajon dhe u pasua nga një periudhë e njohjes dhe prej diplomacisë ndërkombëtare. Shumë vende, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe shumica e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, e njohën Kosovën si një shtet të pavarur sovran. Megjithatë, Serbia dhe disa vende të tjera, përfshirë Rusinë dhe Kinën, nuk e njohën pavarësinë e Kosovës. Nga ky moment, çështja e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në mes Kosovës dhe shtetit të interesuar për të kundërtën, Serbisë, do të mund të orientohej drejt mekanizmave institucionalë ligjorë ndërkombëtarë, që merren me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Një mundësi e tillë është përdorur shumë rrallë në praktikën e zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare, por gjithsesi, ekziston si mundësi hipotetike. Kjo zgjidhje e marrëveshjeve në rrugë ligjore përdoret shumë rrallë për shkak të mungesës së mekanizmave, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të mungesës së kriterëve të përgjithshme zbatuese për përcaktimin e shtetësisë, për rastet specifike. Kështu po mendojmë se Serbia i kishte të gjitha shanset, pas këtij momenti, për t'iu drejtuar një gjykate ndërkombëtare me juridiksione mbi shtetet. Mirëpo, a mund ta bëjë një gjë të tillë ky shtet, kur mbi atë (pavarësisht se aktorët drejtues të vitit 2010 ishin të tjerë nga ato të vitit 1999) rëndonin/rëndojnë ende përgjegjësi të mëdha, për masakra shtetërore kolektive ndaj shqiptarëve të Kosovës, për shpërngulje të mbi një milion banorëve të këtij entiteti, më 1999?

Udhëheqja e Serbisë së asaj kohe, kishte pak shanse për të bërë një rekurs të tillë ligjor në një gjykatë ndërkombëtare, për të ndaluar ligjërisht procesin e mëvetësimit të Kosovës, mbasi çështja normalisht do të ishte një diskutim, që me pak kujdes profesional juridik prej palës së qeverisë kosovare, mund të shndërrohej në një çështje kundër shtetit të Serbisë. Këtu kam parasysh, jo vetëm reperkusionet në çështjen e integritetit të Serbisë mbi Kosovën, por edhe dëmshpërblimet individuale dhe kolektive që do të duhej të paguante, për dëmet humane dhe materiale të luftës së zhvilluar atje, më 1998 dhe 1999. Mjafton të kujtojmë rastin e statusit të Kroacisë, para Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për Jugosllavinë, kur çështja e shtetësisë së Kroacisë u ngrit si një çështje incidentesh dhe u shndërrua në një precedent për njohjen e shtetësisë së këtij vendi.

Kësisoj, Serbia edhe më tutje ishte e shtrënguar të përdorte jo mekanizmat ligjorë për t'i dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes, por vetëm mekanizmin e presionit politik (siç vepron edhe sot), mbështetur në vicklat hapësinore të lëna në mënyrë të papërcaktuar, në të drejtën ndërkombëtare (nga Rezoluta 1244), mbështetur nga aleati i saj historik, Rusia. Mekanizmi politik mbështetet para së gjithash, në veton ruse në Këshillin e Sigurimit. Mirëpo tashmë, pas shpalljes së pavarësisë, njohjes ndërkombëtare dhe vendimit të Gjykatës së Hagës, votimi në Këshillin e Sigurimit ishte një fazë e kapërcyer dhe hapi i ardhshëm i bashkësisë ndërkombëtare, u bë pranimi individual i pavarësisë së mirëfilltë. Në këtë rast, Plani i Ahtisarit nuk do të ishte gjë tjetër, veçse një instrument perfekt, tashmë, për implementimin e përshtatshëm dhe të gjithanshëm të kësaj pavarësie dhe kornizimin e plotë kushtetues dhe administrativ.

Duhet të kujtoj edhe një çështje tjetër: një aspekt tjetër shumë delikat për Serbinë, ishte edhe dobësia që ajo kishte asokohe në lidhje me ndryshimin e vazhdueshëm të statusit të saj ndërkombëtar, në një periudhë që fillon me inicimin e procesit dezintegrues jugosllav, më 1990 dhe vazhdoi gjatë, së paku me procesin e plotë dezintegrues dhe ndarjen e pronësive shtetërore. Madje çështja e Jugosllavisë, pjesë e së cilës barazisht, nga pikëpamja konstitucionale federative, ka qenë Serbia edhe Kosova, përbën një *casus* të tejzgjatur kundërshtish në trajtimin e të drejtës ndërkombëtare. Në fillësë, Serbia dhe Mali i Zi pretenduan se përbënin të njëjtin shtet si ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, por tani thirrur ndryshe: Republika

Federative e Jugosllavisë.

Ky pretendim u hodh poshtë prej shteteve të tjera dhe prej OKB-së, të cilët këmbëngulën se Republika Federative e Jugosllavisë (Serbia e Millosheviqit ndërkaq, kishte hequr përdhunshëm statusin federal të Kosovës, ndërsa Kosova kishte shpallur pavarësinë nga ish-Jugosllavia dhe kishte ndërtuar organet e veta independente të qeverisjes) ishte një prej pesë shteteve pasuese, deri më tani, të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Madje, përfaqësuesit e qeverisë qendrore të Beogradit, nuk u lejuan të zinin vendin e Jugosllavisë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, në Nju Jork. Republika Federative e Jugosllavisë u pranua në OKB në vitin 2000, me statusin e një shteti pasues. Duhet të kujtojmë sërish në këtë kontekst, se me Rezolutën 1244, të vitit 1999, OKB-ja kishte krijuar tashmë paraprakisht një regjim të posaçëm të protektoratit ndërkombëtar mbi Kosovën. Më pas Republika Federative e Jugosllavisë ndryshoi kushtetutën dhe emrin e saj në Serbi dhe Mali i Zi.

Pas këtij ndryshimi fshiheshin pikëpyetje serioze të identitetit, pyetje të cilat shkaktuan mjaft mëdyshje, edhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në vitin 2006, pas referendumit të mbajtur në Mal të Zi, edhe ky vend u shpall nga Bashkësia dhe të dy shtetet, janë tashmë, të pavarura nga njëri-tjetri dhe zënë vende të ndryshme në OKB. 3 vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 22 korrik 2010. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë do të shpallte vendimin e vet, se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 dhe as Kornizën Kushtetuese të përcaktuar nga UNMIK-u; se Pavarësia e Kosovës, shpallja e saj ishte në një linjë me të drejtën ndërkombëtare.¹⁵ Ky vendim u mirëprit nga Gjermania dhe SHBA-ja dhe pjesa më e madhe e vendeve demokratike të botës. Linja e ndjekur në këtë shpjegim nga ne shumë herë në lidhje zbatimin e parimit të *Utti Posseditis*, që shërben për të ruajtur kufijtë e kolonive që shndërrohen dhe lindin si shtete, në rastin e Kosovës funksionoi. Thënë shkurt, derisa e zotëron një territor, këtë territor administruesit, populli sovran i tij dhe organet e zgjedhura demokratikisht do ta zotërojnë definitivisht atë vend dhe independenca e tij është legjitime.

¹⁵ <https://icj-cij.org/sites/default/files/case-related/141/16012.pdf>

Duhet të kujtojmë se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) lëshoi këtë opinion këshillues në vitin 2010, jo sipas kërkesës së Serbisë, siç e analizuam më lart, por në përgjigje të një kërkesë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Opinioni i GJND-së theksoi se shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky opinion ishte këshillues dhe jodetyrues dhe nuk ndryshoi ndjeshëm peizazhin politik apo diplomatik dhe aq më pak qëndrimin e Serbisë. Mirëpo Serbia vetë, për një periudhë 18-vjeçare, ka pasur një situatë krejtësisht, të paqëndrueshme për sa i përket statusit ndërkombëtar të shtetit dhe të territorit mbi të cilin ky shtet e ka shtrirë sovranitetin.

Dezintegrimi i Jugosllavisë dhe reduktimi territorial i Serbisë, me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës dhe njohjen ndërkombëtare të saj, mund të themi se ishte një punë e përfunduar. Vjecka e fundit juridike e këtij ndryshimi mbetet njohja reciproke mes Serbisë dhe Kosovës, që do t'i jepte fund edhe Rezolutës 1244, që formalisht është ende në fuqi. Njohja e kësaj dialektike të dezintegrit, deri në elementin e fundit zhvillimor nga ana e shtetit të sotëm demokratik të Serbisë, do të mund të përbënte një shans shumë të rëndësishëm përshpejtues të procesit të vendosjes së lirisë dhe paqes në mënyrë të qëndrueshme në Evropën Juglindore dhe rrugës së njëkohshme të të gjitha vendeve të rajonit në proceset integruuese europiane dhe atlantike. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe zhvillimet e mëvonshme kanë mbetur një çështje komplekse dhe kontestuese në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe statusi i Kosovës vazhdon të jetë temë e debatit dhe negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe në bashkësinë më të gjerë ndërkombëtare.

Edhe aksioni i ndërtimit të paqes dhe lirisë së vërtetë nuk ka përfunduar as për vetë Kosovën: udhëheqësia legjitime e Kosovës, ka nga ana e saj mbi vete, përgjegjësinë historike të ndërtimit të themeleve të sigurta të një shteti të njëmendtë evropian, të hapur dhe të lirë për të gjithë shtetasit e Kosovës, pa dallim kombësie dhe religjioni, të orientuar nga Perëndimi dhe të mbyllur ndaj mbrapshtive të infiltrimeve destabilizuese për nocionin shqiptar. Do të më duhet të them, se Kosova e sotme dhe e nesërme, me një sipërmarrje aq të rëndësishme historike për mëvetësim paqësor dhe rindërtim të vërtetë demokratik, ka nevojën e udhëheqjes prej një brez i ri iluministësh kosovarë të edukuar në kolegjet më të mira perëndimore dhe që ky vend i ka

me shumicë. Kosova do të duhet të ruhet medoemos nga sëmundjet post-diktatoriale që kanë kapërthyer shtetin amë, që e kanë origjinën në një sërë faktorësh ekonomikë, politikë, socialë e kulturorë, por edhe në mungesën e burrave të shtetit, të cilët do të duhet të punonin për lehtësimin dhe orientimin e përshtatshëm drejt lirisë, demokracisë, laicizmit të pastër dhe perëndimizimit. Liria, mund të themi që ka ardhur, tashmë, për Kosovën. Por lirinë nuk mjafton që ta fitojmë, por atë do të duhet ta dimë që ta mbajmë me dinjitetin e një populli të lashtë të kontinentit të vjetër. Kjo është pjesa më e vështirë e biznesit të ardhshëm shtetformues, për të cilën presidenti Ibrahim Rugova e ka lënë trashëgimi.